



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Ministarstvo Poljoprivrede,
Šumarstva i Ruralnog Razvoja - Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development**

Në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 1.3 (d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, neni 6 paragrafi 6.4, neni 43 paragrafi 43.1 dhe 43.8 si dhe neni 44 paragrafi 44.1 Ligji Nr.02/L-8 për verërat, dt. 14 tetor 2005, Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,

Miraton:

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 11/2009
Për caktimin e kriterëve për importin, eksportin dhe tregtinë e brendshme të verës dhe prodhimeve tjera nga rrushi dhe vera

Neni 1
Qëllimi

1. Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohen kriteret që duhet të aplikohen për importin, eksportin, tregtinë e brendshme të verës dhe prodhimeve tjera të përpunimit nga rrushi dhe vera.
2. Ky udhëzim administrativ i përcakton kushtet për të gjithë personat juridik të cilat merren me importin, eksportin dhe tregtinë e brendshme të verës nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 2
Procedurat e importit të verës dhe prodhimeve tjera nga rrushi

1. Personi juridik i cili ushtron veprimtarinë nga neni 1 i këtij udhëzimi administrativ, duhet të jenë të licencuar në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Entin e Vreshtarisë dhe Verëtarisë Rahovec dhe të plotësojnë këto kushte:

Importuesi i verës duhet të paraqes në formë të shkruar kërkesën për dhënien e dëshmisë për kualitetin e verës, dhe prodhimeve tjera të përpunimit nga rrushi dhe vera që importohen, në mbështetje të deklaracionit për origjinën e produktit;

Kërkesës nga nënparagrafi 1.1 i këtij neni i bashkëngjitet certifikata përkatësisht rezultatet e analizave nga laboratorit i autorizuar i vendit eksportues;

Personi i autorizuar i merr (4) katër shishe të mostrave nëse është e mundur edhe më shumë shishe kur volumi i tyre është i vogël;

Mostrat merren në pikën hyrëse doganore të kontingjentit;

Personi i autorizuar është i obliguar të lëshon vërtetim për marrjen e mostrave;

Mostrat e marra dërgohen në laboratorin e autorizuar për analiza laboratorike, me ç'rast bëhet krahasimi me rezultatet e testeve të vendeve eksportuese, dhe me dispozitat e legjislacionit në fuqi;

Nëse mostra nuk përputhet me rezultatet e analizave fizike kimike i nënshtrohet vlerësimit organoleptikë;

Ankesa për vlerësim mund të paraqitet brenda (8) tetë ditëve nga dita e marrjes së vlerësimit;

Pas përfundimit të procedurave, nëse plotësohen të gjitha procedurat formale që janë të specifikuar në legjislacionin në fuqi dhe me këtë udhëzim administrativ, importuesi merr raportin e analizave për kualitetin e verërave dhe prodhimeve tjera të përpunimit nga rrushi dhe vera që importohen e në bazë të dëshmisë së raportit të analizave kryhet doganimi;

Nëse mostra vlerësohet negativisht atëherë importuesi duhet të zgjedhë, ta kthej verën, në vendin eksportues ose ta përdorë për prodhime tjera, duke siguruar përmbushjen e kushteve të kërkuara sipas legjislacionit në fuqi, por ky prodhim nuk lejohet të tregtohet në territorin e Republikës së Kosovës;

Rezultatet e vlerësimit të dytë – super analizës duhet të kryhen në ndonjë laborator të akredituar sipas standardeve të Bashkësisë Evropiane dhe ato janë përfundimtare.

Shpenzimet e krijuara nga nënparagrafi 1.11 i bartë parashtuesi i kërkesës.

Importuesi, duhet të evidentoi produktin sipas legjislacionit në fuqi.

2. Importuesve të verës, të cilëve u janë lejuar kuotave preferenciale të zbatuara nga Bashkimi Evropian u lëshohen vendimet për importin e verës në bazë:

1.1 Kërkesës për dhënie të vendimit për importin e verës që i është paraqitur Entit të Vreshtarisë dhe Verëtarisë në Rahovec;

1.2 Një kopje të vendimit për miratimin e kuotave preferenciale në Bashkësinë Evropiane nga ana e MBPZHR-së, importuesi e dërgon në Entin e Vreshtarisë dhe Verëtarisë - Rahovec;

1.3 Certifikatën e kualitetit të lëshuar nga instituti i verifikuar i vendit eksportues i licencuar nga Bashkimi Evropian.

Neni 3

Importi i verës dhe prodhimeve tjera nga rrushi dhe vera

1. Procedura e lejimit të importit të verës dhe prodhimeve tjera të përpunimit nga rrushi dhe vera përfshinë:

1.1 Paraqitja e kërkesës për regjistrim dhe pajisjen me licencë për importin e verës dhe prodhimeve tjera nga rrushi dhe vera, në Entin e Vreshtarisë dhe Verërave në Rahovec. Kërkesa për regjistrim merret në Entin e Vreshtarisë dhe Verërave - Rahovec.

1.2 Të gjithë personat juridik importues të rrushit, verës dhe prodhimeve tjera të përpunimit nga ato duhet të pajisen me numrin identifikues të ndërmarrjes tetë (8) shifror,

1.3 Licenca lëshohet për tri (3) vite me mundësi vazhdimi.

1.4 Për marrjen e licencës, importuesi i verës dhe prodhimeve tjera nga rrushi dhe vera paguajnë taksën në shumën prej 100€

Neni 4

Eksporti i verës dhe prodhimeve tjera nga rrushi dhe vera

1. Personat juridik të cilët ushtrojnë veprimtarinë nga neni 1 i këtij udhëzimi administrativ për eksportin e verës, dhe prodhimeve tjera nga përpunimi i rrushit dhe verës së eksportuar, duhet t'i përmbushin kushtet sipas legjislacionit në fuqi e në veçanti kriteret e kërkuara nga vendi importues, si në vijim:

1.1 Eksportuesi paraqet kërkesën në Entin e Vreshtarisë dhe Verërave në Rahovec për lëshimin e dëshmisë për kualitetin e verës dhe prodhimeve tjera nga rrushi dhe vera të cilat duhet të eksportohen;

Prodhuesit që dëshirojnë të eksportojmë, duhet ti përcjell procedurat dhe format e qarkullimit të brendshëm sipas legjislacionit në fuqi dhe me këtë udhëzim administrativ;

Eksportuesi është i obliguar që më së paku (8) tetë ditë para se të filloj eksportin në Entin e Vreshtarisë dhe Verërave në Rahovec, të dorëzoj (4) katër mostra për analizë në institucionin e autorizuar nga Ministria;

Pas pranimit të mostrave ato shifrohen dhe dërgohen për analizë laboratorike:

1.1.1 për të gjitha llojet e verërave si verërat e tryezës, cilësore dhe kulminante nga personi i autorizuar në Entin e Vreshtarisë dhe Verëtarisë,

1.1.2 në bazë të rezultateve të analizave, eksportuesit i jepet dëshmia për shkallën e cilësisë së verës në produktin e analizuar.

1.5 Në rast të eksportimit të verës në vendet e Bashkësisë Evropiane dhe jashtë saj eksportuesi është i obliguar që t'i ofroj Entit të Vreshtarisë dhe Verërave në Rahovec emrin e plotë dhe adresën e importuesit, dhe (2) dy shishe nga vera e cila paraprakisht ka kaluar vlerësimin analitikë jo më larg se tre muajt e fundit;

1.6 Vera që eksportohet refuz kompania eksportuese në Entin Vreshtarisë dhe Verërave duhet të sjell dëshmi atestin për dezinfektimin e autocisternës nga një autoritet i licencuar para se ajo të ngarkohet me verë. Kompania e cila merr përgjegjësin për transportimin e verës është përgjegjëse edhe për pastërtinë e cisternës;

1.7 Kompanitë prodhuese të verës mund të blejnë verë nga tërë Zona Vreshtarë në Kosovë, por paraprakisht duhet të bëjnë lajmërimin në Entin e Vreshtarisë dhe Verërave i cili përcakton subjektin ekonomik prej të cilit është kryer blerja, llojin e verës, vitin e prodhimit, njësinë mbushëse në litra, dhe sasinë e blerë e cila duhet të etiketohet sipas legjislacionit në fuqi. Para mbushjes kjo verë duhet ta ketë vlerësimin analitikë jo më larg se tre muajt e fundit.

Neni 5

Procedurat për eksportin e verës

1. Procedura e lejitimit të eksportuesit të verës dhe prodhimeve tjera të përpunimit nga rrushi dhe vera, duhet të përfshijë:

1.1 Kërkesën për lëshimin e certifikatës për cilësinë e verës dhe produkteve tjera nga rrushi dhe vera që eksportohet, parashtrohet në Entin e Vreshtarisë dhe Verërave në Rahovec;

1.2 Kërkesa për analizat laboratorike fizike-kimike të verës dhe produkteve tjera nga rrushi dhe vera e cila eksportohet, merret në Entin e Vreshtarisë dhe Verërave në Rahovec;

1.3 Paraqitja e kërkesës për regjistrim dhe pajisje me licencë për eksportin e verës dhe prodhimeve tjera nga rrushi dhe vera bëhet, në Entin e Vreshtarisë dhe Verërave në Rahovec;

1.4 Të gjithë personat juridik eksportues të rrushit, verës dhe prodhimeve tjera të përpunimit nga ato duhet të pajisen me numrin identifikues të ndërmarrjes tetë (8) shifror,

1.5 Licenca lëshohet për (3) tri vite me mundësi vazhdimi.

1.6 Për marrjen e licencës së eksportuesit të verës dhe prodhimeve tjera nga rrushi dhe vera paguajnë taksën në shumën prej 50€

Neni 6

Të gjitha të hyrat që rrjedhin nga zbatimi i këtij udhëzimi administrativ derdhën në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Neni 7

Pjesë përbërëse e këtij udhëzimi administrativ është Aneksi 1, 2, 3, 4 dhe 5.

Neni 8

Moszbatimi i këtij Udhëzimi Administrativ, sanksionohet sipas nenit 48 paragrafi 48.1 pika (a) të Ligjit Nr. 02/L-8 për Verërat.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, më 20.10.2009

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministri,
Idriz Vehapi
